VENDIM
Nr. 398, datë 18.6.2014

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 530, DATË 13.7.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PJESËMARRJE NË OPERACIONIN USHTARAK "ISAF", NË KANDAHAR, AFGANISTAN"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, pika 5, e 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, "Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe të kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit", të ndryshuar, dhe të nenit 14, pikat 6 e 11, të ligjit nr. 8671, datë 26.10.2000, "Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shkronja "a", e pikës 5, të vendimit nr. 530, datë 13.7.2010, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:

"a) dieta për ditët e qëndrimit, në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;".

2. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama